



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_ / \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

**Shtojca 12**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT PARAPRAK**

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

[ \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022 ]

Drejtuar: **BOE “2Z KONSTRUKSION” Sh.p.k., “I.C.C GROUP” Sh.p.k. dhe “VISCONS GROUP” Sh.p.k., me përfaqësues të bashkimit “I.C.C GROUP” Sh.p.k: “2Z KONSTRUKSION” Sh.p.k. me NIPT J63229466K dhe adresë Fier Roskovec Strum Fshati Suke i sipërm, Nr 2, Rruga Strum - Sukë, Km 3, Lagjja Zoga, “I.C.C GROUP” Sh.p.k. me NIPT L51308006A dhe adresë Tiranë Njësia bashkiake Nr.4, Rruga 5 Maji, Kompleksi AREELA, Pallati 2, Shkalla 1, Apartamenti 21 dhe “VISCONS GROUP” Sh.p.k. me NIPT L96513208E dhe adresë Vlorë Lagjja 28 Nentori, Pallati Invest, kati 1.**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: e hapur - prokurim me mjete elektronike – punë publike.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-23748-04-01-2022, Loti 2 - REF- 23752-04-01-2022.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i qendrave shëndetësore (viti 2022-2023)”** me fond limit 103,918,778.40 (njëqind e tre milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetëmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë .40) Lekë pa TVSH, ndarë në lote:

**Lot.2 “Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 objekte)”** me fond limit 38,223,795.24 (tridhjetë e tetë milion e dyqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë .24) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:

Lot.2 “Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 objekte)” – 4.6 muaj nga nenshkrimi i process verbalit te fillimit te punimeve (per objektin e pare).

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): **Nuk ka**

Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 46 datë 11 Prill 2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

<b>1.</b>	<b>NDERTIMI shpk me NIPT K11325002C dhe me adresë Tiranë Rruga e Durrësit, Apartamenti</b>
-----------	--

	Nr.3, Zona Kadastrale Nr.8310, Numër Pasurie 10/178/ND+1-3, (Zyrë), ofertuar me vlerën <b>26,652,152.00 lekë pa TVSH.</b>
2.	<b>2 N shpk</b> me NIPT <b>L31615017L</b> dhe me adresë Tiranë Paskuqan Lagjja "Paskuqan Fushë", Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2, Kati i Parë ofertuar me vlerën <b>26,933,026.00 lekë pa TVSH.</b>
3.	<b>BOE 2Z KONSTRUKSION shpk</b> me NIPT <b>J63229466K</b> dhe adresë Fier Roskovec Strum Fshati Suke i sipërm, Nr 2, Rruga Strum - Sukë, Km 3, Lagjja Zoga, <b>I.C.C GROUP shpk</b> me NIPT <b>L51308006A</b> dhe adresë Tiranë Njësia bashkiake Nr.4, Rruga 5 Maji, Kompleksi AREELA, Pallati 2, Shkalla 1, Apartamenti 21 dhe <b>VISCONS GROUP shpk</b> me NIPT <b>L96513208E</b> dhe adresë Vlorë Lagjja 28 Nentori, Pallati Invest, kati 1, <i>përfaqësues i këtij bashkimi është OE "I.C.C GROUP" Sh.p.k me NIPT L51308006A</i> , ofertuar me vlerën <b>32,130,802.00 lekë pa TVSH.</b>
4.	<b>FLED shpk</b> me NIPT <b>K17621104C</b> dhe me adresë Berat Kozarë HAVALEHAS Lagjja "Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307. ofertuar me vlerën <b>32,278,037.00 lekë pa TVSH.</b>
5.	<b>BOE ASI-2A CO shpk</b> me NIPT <b>K53002402C</b> dhe adresë Fier Rruga Skenderbeu, Lagjja Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6 dhe <b>BEQIRI shpk</b> me NIPT <b>J98624801V</b> dhe me adresë Fier Lagjja 15 Tetori, rruga Todi Shkurta, pallati 10 katësh me nr-47/2, kati i dytë, <i>përfaqësues i këtij bashkimi është OE "ASI-2A CO" shpk me NIPT K53002402C</i> , ofertuar me vlerën <b>32,877,712.52 lekë pa TVSH.</b>
6.	<b>S I R E T A 2F shpk</b> me NIPT <b>K51501008J</b> dhe adresë Kompleksi "SIRETA 2F", Lagjja Babrru Fushë, Njësia Administrative Paskuqan, Tiranë 1047, ofertuar me vlerën <b>33,333,333.00 lekë pa TVSH.</b>
7.	<b>AURORA KONSTRUKSION shpk</b> me NIPT <b>K02017003I</b> dhe me adresë Tiranë Bulevardi Zogu i Parë, Pallati pranë Fakultetit të Shkencave, ofertuar me vlerën <b>34,379,249.00 lekë pa TVSH.</b>
8.	<b>MARTINI KONSTRUKSION &amp; REAL ESTATE shpk</b> me NIPT <b>K81314023A</b> dhe me adresë Tiranë Rruga e Durrësit, Hyrja Nr.3, Pasuria e llojit Bodrum, Nr.4/12+3-B/1, Zona Kadastrale 8210 ofertuar me vlerën <b>37,990,012.47 lekë pa TVSH.</b>
9.	<b>AVDULI shpk</b> me NIPT <b>J66703306O</b> dhe adresë Vlorë Lagjja 10 Korriku, Rruga Perlat Rexhepi, Objekt 3-katesh nr.4, Kati 1 ofertuar me vlerën <b>60,389,001.00 lekë pa TVSH.</b>
10.	<b>DON JURGE shpk</b> me NIPT <b>K33005405Q</b> dhe adresë Fier LEVAN, <b>pa ofertë ekonomike.</b>

\* \* \*

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. NDERTIMI shpk** me NIPT **K11325002C** dhe me adresë Tiranë Rruga e Durrësit, Apartamenti Nr.3, Zona Kadastrale Nr.8310, Numër Pasurie 10/178/ND+1-3, (Zyrë), ofertuar me vlerën **26,652,152.00 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

Gjatë verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga ky operator, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vënë re se ka mospërputhje lidhur me Listëpagesën e dorëzuar për Muajin Shkurt.

Në DST, Shtojca 7, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit në pikë 2.3.4 kërkohet:

*2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve për periudhën Shkurt 2022 të jetë jo më i vogël se 45 punonjës në muaj (përfshirë dhe stafin drejtues teknik dhe stafin me certifikate IQT ose e barazvlefshme), të vërtetuar me:*

*a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj per periudhen Shkurt 2022*

*b. List - pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Shkurt 2022*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te DST.*

*Pra sipas DST, lidhur me kriterin e mësipërm, do të konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator në SPE, rezulton që OE “Ndërtimi” Shpk., të ketë dorëzuar në SPE përveç Shtojcës 8 për vetëdeklarimet, edhe Listëpagesën për Muajin Shkurt të kësaj shoqërie.

Në momentin e dorëzimit të dokumentave fizike pranë AK sipas njoftimit të marrë nga KVO-ja, gjatë shqyrtimit të tyre, vërehen mospërputhje të dhënash midis Listëpagesës së Muajit Shkurt të dorëzuar në SPE (pra dorëzuar në sistem para afatit për hapjen e ofertave) dhe Listëpagesës së Muajit Shkurt të dorëzuar fizikisht pranë AK-së pas njoftimit të klasifikimit (pra në datën 03.06.2022).

Nisur nga kjo mospërputhje të dhënash në listëpagesën e dorëzuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është gjendur në kushtet kur nuk mund të vazhdojë me procesin e verifikimit të dokumentave të këtij operatori pasi ka dyshimi lidhur me vërtetësinë e tyre.

Ne vijim te komunikimeve me Drejtorinë e Tatimeve Tirane, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave lidhur me dokumentat e paraqitura nga OE “Ndërtimi” Shpk., ka arritur në këtë konkluzion:

**1. Në DST kërkohet:**

**2.3.7. Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar në list-pagesa:**

*punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI (ish –IQT) ose ekuivalente me të, të vlefshme:*

*min 2 (dy) teknik ndërtimi; min 3 (tre) punonjës elektrikist; min 3 (tre) punonjës hidraulik/mekanik; min 3(tre) punonjës murator; min 3 (tre) punonjës pllakashtrues; min 3 (tre) punonjes bojaxhi; min 2(dy) punonjës hidroizolues, min 2 (dy) suvatues; - min 2(dy) punetor d/alumini; - min 2 (dy) punetor cmontimi dyer,dritare;*

*Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik si dhe kontrata e punes (te vlefshme).*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 te DST.*

Sa më lart, referuar kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.7 të DST është kërkuar stafi si më sipër, për të cilin duhet të paraqitet deshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik si dhe kontrata e punës (të vlefshme), si dhe është kërkuar të figurojnë në listëpagesat (e shoqërisë) për periudhën e kërkuar në DST.

Listëpagesën e Muajit Shkurt dorëzuar **në SPE (para afatit të hapjes së ofertave)** lidhur me plotësimin e kriterit të kualifikimit në pikën 2.3.7 të Shtojcës 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të DST, **rezulton si më poshtë:**

1. J.Veseli është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Elektracist, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **7112.05 Murator për mur tulle;**
2. Z.Lala është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Elektracist, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **9622.01 Puntor krahu;**
3. D.Cobo është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Tek. Ndërtimi, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **2142.12 Inxhinjer per ndertesa;**

4. V.Bufazi është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Mekanik, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **7114.04 Hekurkthyes**;
5. E.Lala është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Mekanik, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **9622.01 Puntorë krahu**;
6. A.Salaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Murator, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **9622.01 Puntorë krahu**;
7. D.Muco është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Murator, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **7212.09 Saldator**;
8. K.Brati është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Puntor D/Alumini, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **7411.13 Elektracist per ndertesa**;
9. N.Lala është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Puntor D/Alumini, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **9622.01 Puntor krahu**;
10. J.Bali është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Pllakashtrues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **2142.12 Inxhinjer per ndertesa**;
11. B.Shahini është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Pllakashtrues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **7126.03 Hidraulik**;
12. L.Lika është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Pllakashtrues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **9622.01 Puntor krahu**;
13. V.Manaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Hidroizolues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **7114.04 Hekurkthyes**;
14. F.Isufi është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Hidroizolues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **2161.01 Arkitekt ndertesash**;
15. Xh.Cullhaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Puntor Cmontues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **8332.14 Shofer kamjoni**;
16. A.Daupaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Puntor Cmontues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **7212.09 Saldator**;
17. Sh.Sakaj është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Suvatues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **7114.04 Hekurkthyes**;
18. A.Rapi është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Suvatues, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **7131.07 Bojaxhi per ndertesa**;
19. B.Xhabafti është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Bojaxhi, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **8111.04 Makinist punimesh ne siperfaqe**;
20. I.Laba është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Bojaxhi, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **2161.01 Arkitekt ndertesash**;

21. K.Bali është deklaruar në **Shtojcën 8 të DST (Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit)**, me profesion Bojaxhi, ndërkohë në listëpagesë është deklaruar me kodin **2142.12 Inxhinjer per ndertesa**.

Në listëpagesën e dorëzuar në formë fizike pranë AK/MSHMS në datën 03.06.2022 rezulton të jenë bërë ndryshimet (sipas emailit të nisur nga Dretoria Tatimore Tiranë) si më poshtë: Ndryshimi i kodeve të profesionit bëhen nga vetë tatimpaguesi dhe këto ndryshime të bëra në listëpagesën e fundit (datë 02.06.2022) paraqiten sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Punonjësi	kodi mëparshem	kodi i ndryshuar
1	Bledjon Xhabafti	8111.04 Makinist punimesh ne siperfaqe	7131.07 Bojaxhi
2	Zaim Lala	9622.01 Puntor krahu	7411.01 Elektracist
3	Klajdi Bali	2142.12 Inxhinjer per ndertesa	7131.07 Bojaxhi
4	Xhevdet Cullhaj	8332.14 Shofer kamjoni	8215.01 Montues mobilje druri
5	Dorjan Cobo	2142.12 Inxhinjer per ndertesa	3119.15 Teknik ndertimi
6	Lirim Lika	9622.01 Puntor krahu	7122.07 Shtrues pllakash
7	Namik Lala	9622.01 Puntor krahu	7122.06 Puntor duro alumini
8	Ervis Lala	9622.01 Puntor krahu	7233.04 mekanik per makineri industriale
9	Igli Laba	2161.01 Arkitekt ndertesash	7131.07 Bojaxhi per ndertesa
10	Kastriot Brati	7411.13 Elektracist per ndertesa	7119.06 Puntor duro alumini
11	Shkelqim Sakaj	7114.04 Hekurkthyes	7123.03 Suvatues
12	Alfred Daupaj	7212.09 Saldator	8215.01 Montues mobilje druri
13	Veis Bufazi	7114.04 Hekurkthyes	7233.04 mekanik per makineri industriale
14	Jurgen Bali	2142.12 Inxhinjer per ndertesa	7122.07 Shtrues pllakash
15	Fation Isufi	2161.01 Arkitekt ndertesash	7124.01 Puntor izolimi
16	Artan Rapi	7131.07 Bojaxhi per ndertesa	7123.03 Suvatues
17	Jonus Veseli	7112.05 murator per mur tulle	7411.01 Elektracist
18	Arben Salaj	9622.01 Puntor krahu	7112.05 murator per mur tulle
19	Bledi Shahini	7126.03 Hidraulik	7122.07 Shtrues pllakash
20	Dashamir Muco	7212.09 Saldator	7112.05 murator per mur tulle

Të gjithë punonjësit e deklaruar në shtojcë për plotësimin e kriterëve të DST, deri më datë 02.06.2022 (rikujtojmë se vlerësimi në sistem është mbyllur më datë 24.05.2022) kanë qenë me kode të cilat **NUK** përkonin me kodet e profesioneve të kërkuara në DST.

Kjo e vërtetuar nga listëpagesa e ngarkuar në sistem nga vetë operatori e cila është me vule dhe me firmë digjitale nga ku vërtetohet origjinaliteti i dokumentit.

Pra deklarata e OE për plotësimin e kushtit të përcaktuar në DST nuk ka qenë në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga AK, gjatë kohës së vlerësimit të kësaj procedure e deri në mbyllje të vlerësimit, kjo e konfirmuar edhe me përgjigjen e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Për sa më sipër operatori ekonomik ka ndërhyre në mënyrë të padrejtë dhe për qëllim për të kthyer një ofertë të pavlefshme në një ofertë të vlefshme.

Në Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në neni 92 pika 1 parashikohet si më poshtë:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. **Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.**

Pranimi i nje dokumenti te ndryshuar nje dite pas njoftimit per dorezim dokumentacioni, do te perbente nje favorizim per kete operator dhe vendosjen e tij jo ne kushte te barabarta me operatoret e tjere pjesemarres ne kete procedure.

Pas verifikimit të dokumentacionit të OE Ndërtimi Shpk., rezulton se nuk përmbush kapacitetet teknike sipas kërkesave të DST dhe LPP, **si rrjedhojë oferta e “Ndërtimi” shpk., do të skualifikohet.**

2. **2 N shpk** me NIPT **L31615017L** dhe me adresë Tiranë Paskuqan Lagjja "Paskuqan Fushë", Rruga "Demokracia", Pallati Nr.2, Kati i Parë ofertuar me vlerën **26,933,026.00 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator u konstatua se ka ndryshim të njësisë matëse të llogaritjes së cmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT.

Përkatësisht:

		<b>OBJEKTI: Lagjia Brigada 17 Sulmuese</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>EMËRTIMI I PROCESIT TË PUNËS</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>E. FURNIZIM PAJISJESH</b>		
		<b>III. Furnizim pajisje MKZ</b>		
1	An	F Shuars me bombul me shkume	kg	copë

Ndryshimi i zërit në preventive e bën ofertën e këtij operatori të pa krahasueshme dhe të pamundur në vendosje në kushte të barabarta me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Kjo në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni2 pika d:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji:

*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë

dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

3. **FLED shpk me NIPT K17621104C** dhe me adresë Berat Kozarë HAVALEHAS Lagjja" Havaleas", rruga Ura e kozares Kuçovë, godinë private 1- katëshe, Nr.307. ofertuar me vlerën **32,278,037.00 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator u konstatua se ka ndryshim të njësisë matëse të llogaritjes së cmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT.

Përkatësisht:

		OBJEKTI: Q.SH BORSH LUKOVE/ SARANDE		
Nr	NR.ART	EMËRTIMI I PROCESIT TË PUNËS		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. Punime Ndertimi</b>		
		<b>III. Furnizim pajisje MKZ</b>		
20	2.209	ulluqe shkarkimi vertikal (per 1 cop ulluk me h=13.8m)	copë	ml

		OBJEKTI: QSH ORIKUM		
Nr	NR.ART	EMËRTIMI I PROCESIT TË PUNËS		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. Punime Ndertimi</b>		
		<b>II. Punime ndertimi</b>		
18	2.209	Ulluqe shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø100mm	copë	ml

Ndryshimi e bën ofertën e këtij operatori të pa krahasueshme dhe të pamundur në vendosje në kushte të barabarta me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Kjo në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" neni2 pika d:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- e. të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- f. të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- g. të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- h. të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji:

*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

4. **BOE ASI-2A CO shpk** me NIPT **K53002402C** dhe adresë Fier Rruga Skenderbeu, Lagjia Bishanake, pallati nr 18, hyrja nr. 6 dhe **BEQIRI shpk** me NIPT **J98624801V** dhe me adresë Fier Lagjia 15 Tetori, rruga Todi Shkurta, pallati 10 katësh me nr-47/2, kati i dytë, me *përfaqësues të këtij bashkimi OE "ASI-2A CO" shpk me NIPT K53002402C*, ofertuar me vlerën **32,877,712.52 lekë pa TVSH**.

**Përkatësisht për arsyt e mëposhtme:**

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator u konstatua ka ndryshim të njësisë matëse të llogaritjes së cmimit njësi të ofertës ekonomike nga njësia matëse e llogaritjes e publikuar në DT.

Përkatësisht:

		<b>OBJEKTI: Ambulanca Banaj</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>EMËRTIMI I PROCESIT TË PUNËS</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. Punime Ndertimi</b>		
		<b>II. Punime ndertimi</b>		
19	2.209	Ulluqe shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø100mm	copë	ml

		<b>OBJEKTI: QSH ORIKUM</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>EMËRTIMI I PROCESIT TË PUNËS</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. Punime Ndertimi</b>		
		<b>II. Punime ndertimi</b>		
18	2.209	Ulluqe shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø100mm	copë	ml

		<b>OBJEKTI: Q.SH Borsh LUKOVE/ SARANDE</b>		
<b>Nr</b>	<b>Nr.Art</b>	<b>EMËRTIMI I PROCESIT TË PUNËS</b>		
			<b>NJESIA e ofertuar</b>	<b>NJESIA në DT</b>
		<b>A. Punime Ndertimi</b>		
		<b>3. Punime ndertimi</b>		
20	2.209	ulluqe shkarkimi vertikal (per 1 cop ulluk me h=13.8m)	copë	ml



Ndryshimet e bëjnë ofertën e këtij operatori të pa krahasueshme dhe të pamundur në vendosje në kushte të barabarta me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Kjo në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2 pika d:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) *të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) ***të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;***

dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji:

*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

- Në rastet kur oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, sipas kërkesave të DST kërkohet:
  - *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*

Në marrëveshjen e bashkëpunimit të paraqitur nga ky bashkim, rezulton që:

- Beqiri shpk ka deklaruar se do të realizojë 57.3% të punimeve.

Sipas % së deklaruar ky operator duhet të kishte minimalisht:

- Një teknik ndërtimi;
- Një punonjës elektrikist;
- Një punonjës hidraulik/mekanik;
- Një punonjës murator;
- Një punonjës bojaxhi;
- Një suvatues;
- Një punëtor d/alumini;
- Një punëtor cmontimi dyer,dritare;

**Gjithashtu OE Beqiri shpk ka:**

- 2 motogjeneratorë nga 3 që duhet të kishte minimalisht
- 2 matrapikë nga 3 që duhet të kishte minimalisht
- 1 kamion nga 2 që duhet të kishte minimalisht

Bazuar në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik” të ndryshuar, *Kreun XI, Neni 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 3 përcaktohet:*

***3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***

Si rrjedhojë, operatorët ekonomik pjesë e bashkimit nuk përmbushin kriteret e vecanta të kualifikimit sipas DST, lidhur me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim.

**5. MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE shpk** me NIPT **K81314023A** dhe me adresë Tiranë Rruga e Durrësit, Hyrja Nr.3, Pasuria e llojit Bodrum, Nr.4/12+3-B/1, Zona Kadastrale 8210 ofertuar me vlerën **37,990,012.47 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky operator u konstatua se ka ndryshim të volumeve të ofertuara për dy zëra.

Perkatësisht:

<b>OBJEKTI: QSH BALLAN</b>					
<b>Nr</b>	<b>NR.ART</b>	<b>EMËRTIMI I PROCESIT TË PUNËS</b>			
			<b>NJESIA</b>	<b>Sasia e ofertuar</b>	<b>Sasia ne DT</b>
<b>A. Punime Ndertimi</b>					
<b>1. PUNIME PRISHJE</b>					
2	analize	Heqje pllaka dysHEMEJE perfshi nenshtresat	m <sup>2</sup>	190	150
3	analize	Heqje shtrese suvatimi + xokoli + transport mbeturinash 5 km	m <sup>2</sup>	500	250

Ndryshimet e volumeve e bëjnë ofertën e këtij operatori të pa krahasueshme dhe të pamundur në vendosje në kushte të barabarta me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë procedurë.

Kjo në zbatim të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni2 pika d:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

dhe të nenit 3 pika 1 të këtij ligji:

*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

**6. AVDULI shpk** me NIPT **J66703306O** dhe adresë Vlorë Lagjja 10 Korriku, Rruga Perlat Rexhepi, Objekt 3-katesh nr.4, Kati 1 ofertuar me vlerën **60,389,001.00 lekë pa TVSH.**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- Nga verifikimi i dokumentacionit të këtij operatori ekonomik, rezulton të ketë probleme me dokumentacionin e paraqitur, pasi një pjesë e tyre janë për Lotin 1 “Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Tiranë dhe Shkodër (13 objekte)” me fond limit 65,694,983.16 (gjashtëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre .16) lekë pa TVSH, (ku gjithashtu ka marrë pjesë), dhe jo për Lot.2 “Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 objekte)” me fond

limit 38,223,795.24 (tridhjetë e tetë milion e dyqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë .24) lekë pa TVSH, loti aktual për të cilin ka dorëzuar dokumenta.

**Gjithashtu, Formulari i Ofertës Ekonomike (sipas Shtojcës 1 dhe 2 të DST) është dorëzuar ai për Lotin 1 dhe jo për Lotin 2, duke sjellë një ofertë më të lartë nga fondi limit i Lotit 2 dhe preventive të gabuar (pasi është preventi i Lotit 1).**

**Operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit është prima-facia i interesuar për procedurës e për rrjedhojë është përgjegjësia e këtij të fundit plotësimi më përgjegjesi dhe me saktësi sipas kërkesave të vendosura nga Autoriteti kontrator, kritere për të cilat operatori nuk ka pasur pretendime në fazën e ofertimit.**

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

**7. DON JURGE shpk me NIPT K33005405Q dhe adresë Fier LEVAN, pa ofertë ekonomike.**

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion dhe as ofertë ekonomike dhe si rrjedhojë nuk kualifikohet.

\* \* \*

Janë kualifikuar si të suksesshme ofertat e mëposhtme:

- 1. BOE 2Z KONSTRUKSION shpk me NIPT J63229466K dhe adresë Fier Roskovec Strum Fshati Suke i sipërm, Nr 2, Rruga Strum - Sukë, Km 3, Lagjja Zoga, I.C.C GROUP shpk me NIPT L51308006A dhe adresë Tiranë Njësia bashkiake Nr.4, Rruga 5 Maji, Kompleksi AREELA, Pallati 2, Shkalla 1, Apartamenti 21 dhe VISCONS GROUP shpk me NIPT L96513208E dhe adresë Vlorë Lagjja 28 Nentori, Pallati Invest, kati 1, me përfaqësues të këtij bashkimi OE I.C.C GROUP shpk, ofertuar me vlerën 32,130,802.00 lekë pa TVSH, me vlerë të korrigjuar të ofertës 31,931,653.85 lekë pa TVSH.**
- 2. S I R E T A 2F shpk me NIPT K51501008J dhe adresë Tiranë Paskuqan Lagjja Babrru Fushë, Komuna Paskuqan, ofertuar më vlerën 33,333,333.00 lekë pa TVSH, me vlerë të korrigjuar të ofertës 33,161,319.95 lekë pa TVSH.**
- 3. AURORA KONSTRUKSION shpk me NIPT K02017003I dhe me adresë Tiranë Bulevardi Zogu i Parë, Pallati pranë Fakultetit të Shkencave, ofertuar me vlerën 34,379,249.00 lekë pa TVSH.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE "2Z KONSTRUKSION" Sh.p.k. me NIPT J63229466K dhe adresë Fier Roskovec Strum Fshati Suke i sipërm, Nr 2, Rruga Strum - Sukë, Km 3, Lagjja Zoga, "I.C.C GROUP" Sh.p.k. me NIPT L51308006A dhe**

*adresë Tiranë Njësia bashkiake Nr.4, Rruga 5 Maji, Kompleksi AREELA, Pallati 2, Shkalla 1, Apartamenti 21 dhe “VISCONS GROUP” Sh.p.k. me NIPT L96513208E dhe adresë Vlorë Lagjja 28 Nentori, Pallati Invest, kati 1. me përfaqësues të bashkimit “I.C.C GROUP” Sh.p.k me NIPT L51308006A, se oferta e paraqitur (vlera pa tvsh e korigjuar) prej 31,931,653.85 [tridhjetë e një milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre.85] Lekë/ totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.*

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

\* \* \*

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**JOANA DURO**